



DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PROJEKTEVE, POLITIKAVE, STRATEGJIVE NË FUSHËN E DREJTËSISË DHE E INTEGRIMIT EVROPIAN

# Newsletter

QERSHOR 2023

## EVENTE PUBLIKE


### Takim i Këshillit Kombëtar të Barazisë Gjinore.

Më datë 15.06.2023, u organizua takimi me Këshillin Kombëtar të Barazisë Gjinore, i kryesuar nga Zëvendësmistrja e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Zj. Denda Seferi dhe përfaqësues të institucioneve të linjës. Ministria e Drejtësisë u përfaqësua në këtë takim edhe nga Drejtoria e Politikave dhe Strategjive në Fushën e Drejtësisë, në cilësinë e strukturës teknike për hartimin dhe zbatimin e politikave të sistemit të drejtësisë por që prekin aspektet e barazisë gjinore.



### [Për më shumë.](#)

## NDËRGJEGJËSIMI



### Mbahet takimi i GNPIE për kapitullin 23 “Gjyqësori dhe të drejtat themelore” dhe Kriteri Politik

Ditën e mërkurë, datë 21 qershor 2023, Drejtoria e Integritit dhe Negociatave me praninë e zëvendësministres së drejtësisë, znj. Adea Prideni mbajti online takimin e radhës së Grupeve Ndërinstitucionale të Punës për Integrimin Evropian për Kapitullin 23 “Gjyqësori dhe të drejtat themelore”, “Kriterin politik” si dhe dy grupet ndërinstitucionale të punës për hartimin e udhërrëfyesit për shtetin e së drejtës dhe për funksionimin e institucioneve demokratike.

Në këtë takim zëvendësministrja e drejtësisë dhe njëkohësisht negociatore e kapitullit 23 dhe kriterit politik, znj. Pirdeni falenderoi përfaqësuesit e institucioneve për punën intensive të bërë dhe bashkëpunimin e ndërsjellë për hartimin e dy draft udhërrëfyesve si dhe i njoftoi për iniciimin e procesit të shkrimit të një tjetri dokumenti strategjik, atë të Pozicionit Negociues. Gjatë takimit znj. Pirdeni shpjegoi metodologjinë që duhet përdorur për hartimin e Pozicionit Negociues si dhe udhëzoi institucionet për mbarëvajtjen e punës dhe sigurimin e një dokumenti cilësor.

## Trajnim për zbatimin e OGP - Pjesëmarrja dhe Bashkëkrijimi i Standardeve në Shqipëri.

Në datë 06 Qershor 2023, u zhvillua trajnimi nga Ministri i Shtetit për Standardet dhe Shërbimet, në bashkëpunim me ReSPA, në kuadër të zbatimit të Planit të Veprimit të OGP 2023 – 2025. Trajnimi ofroj aspekte të ndryshme të metodologjisë së re të OGP dhe komunikimit, hartimin e qëllimeve, objektivave dhe implementimin e masave të planeve kombëtare, si dhe ofroj një panoramë lidhur me rëndësinë e shoqërisë civile në këtë proces. Në këtë trajnim morrën pjesë përfaqësues nga Drejtoria e Politikave dhe Strategjive në Fushën e Drejtësisë në Ministrinë e Drejtësisë, në cilësinë e strukturës teknike.

[Për më shumë.](#)



## Trajnim për përmirësimin e cilësive raportuese

Gjatë datave 26 dhe 27 qershor 2023, stafi i Drejtorisë të Politikave dhe Strategjive në Fushën e Drejtësisë dhe Drejtorisë së Integritit dhe Negociatave morën pjesë në trajnimin e mundësuar nga projekti JustAL. Ky trajnim kishte në qendër njohjen me draft manualin e unifikimit të mënyrës së raportimit përgjatë proceseve të punës që këto drejtori kanë në përditshmëri. Gjatë këtij trajnimit stafi përfitoi njohuri praktike mbi mirorganizimin e një dokumenti dhe hartimin e raporteve në mënyrë llogjike dhe koherente.

## Dokumenti Konceptual politik i Strategjisë Ndësektorale të Mbrojtjes të Viktimave të Krimit 2024 – 2030

Qeveria Shqiptare, në vijim të procesit të integritit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian, për herë të parë ka ndërmarë inisiativën për hartimin dhe miratimin e Strategjisë Ndësektorale për Mbrojtjen e Viktimave të Krimit 2024-2030.

Në këtë kuadër, Ministria e Drejtësisë ka hartuar Dokumenti Konceptual të Politikës së Strategjisë Ndësektorale për Mbrojtjen e Viktimave të Krimit 2024-2030, i cili synon të përcaktojë shtyllat kryesore të qëllimeve politike dhe objektivat strategjikë.

[Për më shumë.](#)



## Mbledhja e rradhës e Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile

Drejtorja e Integrimit dhe Negociatave u përfaqësua nga drejtoresha e kësaj drejtorie, znj. Bano në datën 19 qershor 2023 në mbledhjen e rradhës së Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile (KKSHC), në ambientet e Kryeministrisë. Në cilësinë e të fuarit znj. Bano paraqiti rëndësinë e KKSHC si platformë gjithëpërfshirëse e shoqërisë civile në krijimin e një mjedisi mundësues për shoqërinë civile si dhe angazhimin e saj në hartimin e dokumentave strategjikë për procesin e negociatave në Bashkimin Evropian. Gjithashtu, në këtë takim mori pjesë dhe përfaqësuesi nga Drejtoria e Politikave dhe Strategjive në Fushën e Drejtësisë, në cilësinë anëtarit përfaqësues të Ministrisë të Drejtësisë në këtë këshill.



[Për më shumë.](#)



<https://web.facebook.com/drejtesia.gov.al>



[https://www.instagram.com/ministria\\_drejtise/](https://www.instagram.com/ministria_drejtise/)

<https://www.drejtesia.gov.al>